

**PULSAR** 

PERSPEKTIVAT PËR  
TË ARDHMEN

**FINCOP &  
EDUCOP**

DISKUTIM INTELIGJENT NDËRAKTIV  
**RAPORTIMI FINANCIAR  
DHE KONSOLIDIMI NË  
KOHËN E COVID-19**

7 korrik 2020

# CFRR»»

**Centre for Financial  
Reporting Reform**

---



**WORLD BANK GROUP**

Qendra për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR )  
Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vjenë, Austri

Internet: [www.worldbank.org/cfrr](http://www.worldbank.org/cfrr)

Email: [cfrr@worldbank.org](mailto:cfrr@worldbank.org)

Tel: +43-1-217-0700

# PULSAR

Programi për Kontabilitetin dhe Raportimin në  
Sektorin Publik

Web: [www.pulsarprogram.org](http://www.pulsarprogram.org)

## **DISKUTIM INTELIGJENT NDËRAKTIV**

# **RAPORTIMI FINANCIAR DHE KONSOLIDIMI**

# **NË KOHËN E COVID-19**

7 korrik 2020

### **KONTEKSTI**

Qeveritë duhet të udhëheqin kundërpërgjigjen ndaj pandemisë nëpërmjet politikave, bashkërendimit, sigurimit të fondeve dhe zbatimit, çka kërkon veprim të shpejtë e të shkathët. Në të njëjtën kohë, vetë qeveritë janë prekur negativisht, duke qenë se mbajtja e distancës sociale: i) i pengon të punojnë si zakonisht; ii) kërkon procese dhe teknologji të reja për të vijuar operacionet thelbësore të punës dhe ofrimin e shërbimeve publike bazë. Ka nevojë edhe për të balancuar reagimin me llogaridhënien.

Në këto kushte, përgatitja në kohë e pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe vjetore dhe konsolidimi i tyre është një prej elementeve bazë të një menaxhimi të shëndoshë financiar, i cili ka rëndësi kritike dhe për të siguruar nivelet e duhura të transparencës dhe llogaridhënies, sidomos në kohëra me pasiguri si këto që po jetojmë.

Objektivi kryesor i këtij seminari virtual është: i) diskutimi për praktikat e mira ndërkombëtare në hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në kohë situatash të jashtëzakonshme, siç është pandemia e tanishme e COVID-19; ii) prezantimi i përvojës së 2 vendeve anëtare të programit “PULSAR”.

### **VENDNDODHJET DHE ORA**

- 08:00 – Uashington, D.K.
- 14:00 – Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë, Shkup, Tiranë, Vjenë, Zagreb
- 15:00 – Kishinav, Kiev, Minsk
- 16:00 – Baku, Tbilis, Jerevan

## PROGRAMI | E MARTË, 7 KORRIK 2020, 14:00 (CET)

### Fjala e hapjes

Fjala e mirëseardhjes dhe prezantim i shkurtër i temës dhe i folësve

- 14:00** **Dmitri Gourfinkel** | Drejtues i ekipit të projektit, KP-RF, PULSAR; Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore (Drejtues i punimeve të seminarit)  
**Daniel Boyce** | Menaxher Praktike për Qeverisjen në rajonin e EAQ-së, Banka Botërore

### Raportimi financiar në kohën e COVID-19

**14:05**

Fjalimi kryesor mbi rolin që luan raportimi financiar në kundërpërgjigjet e përgjithshme të qeverive & institucioneve

**Edward Olowo Okere** | Drejtor i Praktikës Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

### Raportimi financiar dhe konsolidimi në kohën e COVID-19

**14:10**

Raportimi financiar dhe konsolidimi në kohën e COVID-19: reflektime dhe rekomandime

**Thomas Müller-Marqués Berger** | Partner dhe Drejtues Global për Kontabilitetin Ndërkombëtar në Sektorin Publik, EY, dhe Kryetar, Grupi Këshillimor Konsultativ i BSNKSP-së

### Përvoja e Bashkimit Evropian

**14:25**

Përvoja e vendeve të BE-së në raportimin financiar dhe konsolidimin në kohën e COVID-19

**Livia Shinn Strakova** | Ekipi i SEKSP-ve, Komisioni Evropian, EUROSTAT

### Përvoja e Federatës Ruse

**14:40**

Përvoja e Federatës Ruse në raportimin financiar dhe konsolidimin në kohën e COVID-19

**Anton Dubovik** | Zëvendës drejtor, Thesari Federal, Federata Ruse

## Përvoja e vendeve të programit PULSAR

---

14:55

Përvoja e dy vendeve anëtare të programit PULSAR në raportimin financiar dhe konsolidimin në kohën e COVID-19:

**Hana Zoričić** | Drejtoreshë Drejtorie, Thesari, Ministria e Financave, Kroaci

**Liudmyla Haponenko** | Drejtoreshë e Metodikës së Kontabilitetit të Sektorit Publik, Ministria e Financave, Ukrainë

## Pyetje & Përgjigje

---

15:15

pyetje dhe përgjigje dhe mbyllja e seancës, drejtuar nga

**Patrick Piker Umah Tete** | Bashkëdrejtues i ekipit të projektit, KP-E, PULSAR; Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

**Srinivas Gurazada** | Drejtues i ekipit të projektit, KP-E, PULSAR; Kryespecialist global për menaxhimin e financave publike, Banka Botërore

## Fjala mbyllëse

---

15:25

**Arman Vatyán** | Drejtues i Programit PULSAR; Pikë Qendrore Kontakti për Qeverisjen për Azinë Qendrore, Banka Botërore

15:30

**Fundi i seminarit virtual**

---

## JETËSHKRIMET E FOLËSVE DHE DREJTUESVE TË SEANCËS

(sipas rendit të marrjes së fjalës)



### **DMITRI GOURFINKEL**

Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Drejtues Ekipi për KPRF PULSAR, Banka Botërore

Dmitri Gourfinkel është specialist i lartë për drejtimin financiar pranë Praktikës Globale të Qeverisjes në Bankën Botërore dhe ka 14 vjet përvojë profesionale në menaxhimin e financave publike dhe përputhshmërinë me detyrimet e besnikërisë në një sërë vendesh. Përpara se të fillojë punë në Bankën Botërore në vitin 2007, ka mbajtur disa poste në nivel të qeverisjes qendrore dhe nënqendrore në Meksikë, si Këshilltar i Ministrit të Financave, Kryekëshilltar i Zëvendësdrejtorit të Thesarit të Federatës dhe Kryekëshilltar i Kryetarit të Kontrollit të Shtetit për Qytetin e Meksikos. Dmitri është kontabilist publik i certifikuar nga Instituti Meksikan i Kontabilistëve të Autorizuar dhe ka kryer studimet e nivelit Master për administrim publik pranë fakultetit “Maxwell School of Citizenship dhe Public Affairs” të Universitetit të Sirakuzës. Dmitri është drejtues i ekipit të projektit për nënaktivitetin e kuadrit të raportimit financiar pranë programit PULSAR.



### **DANIEL BOYCE**

Menaxher i Praktikës së Qeverisjes, Banka Botërore

Daniel Boyce është Menaxher Praktikë për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore në Praktikën Globale për Qeverisjen të Bankës Botërore. Sektori që ai drejton mbulon 11 vende të Evropës Lindore, Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore. Është kontabilist publik i certifikuar (CPA), ka diplomë të studimeve universitare në kontabilitet nga Universiteti “A&M” i Floridës dhe mban titullin doktor në shkenca politike nga Universiteti i Kalifornisë, Los Anxhelos (UCLA). Më parë ka drejtuar sektorin e menaxhimit financiar të Bankës Botërore për rajonin e Amerikës Latine dhe Karaibeve. Zoti Boyce është përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së punës që bën Banka Botërore në fushën e qeverisjes, përfshirë punën në fushën e menaxhimit financiar operativ dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve në menaxhimin e sektorit publik. Temat të cilat trajtohen nga praktika e qeverisjes përfshijnë ndër të tjera temat e lidhura me reformën në drejtësi, ndërmarrjet shtetërore dhe menaxhimin e financave publike. Ai luan rol udhëheqës edhe në nisma rajonale të lidhura me menaxhimin e shpenzimeve publike dhe me kontabilitetin në sektorin publik.



### **EDWARD OLOWO-OKERE**

Drejtor i Praktikës Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

---

Ed Olowo-Okere udhëheq ekipin e Bankës Botërore për Menaxhimin Financiar dhe Sektorin Publik pranë Praktikës Globale të Qeverisjes. Puna e këtij grupi përqendrohet në dhënien e ndihmës vendeve për të ngritur institucione të afta, efektive, llogaridhënëse, transparente dhe gjithëpërfshirëse të cilat realizojnë shërbime me qytetarin në qendër, ndihmojnë rritjen e sektorit privat dhe rrisin besimin te qeveria. Ky grup ofron njohuri eksperti për çështje të qeverisjes, të cilat shkojnë që nga menaxhimi i financave publike, mobilizimi i burimeve të brendshme, reformimi/drejtimi i brendshëm i ndërmarrjeve shtetërore, reformimi i institucioneve publike, decentralizimi/qeverisja në nivel nënqendror e deri te politikat kundër korrupsionit, dhënia e sigurisë në kuadër të detyrimit të besnikërisë, analiza e ekonomisë politike dhe gov-tek (pra, shfrytëzimi i teknologjisë për të modernizuar sektorin publik dhe për të përmirësuar realizimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset dhe për të rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien).



### **THOMAS MÜLLER-MARQUÉS BERGER**

Drejtues Global, Kontabiliteti i Sektorit Publik Ndërkombëtar, Ernst & Young

---

Thomas Mueller-Marqués Berger është Partner Auditimi dhe Drejtues Global në Kontabilitetin Ndërkombëtar të Sektorit Publik për Ernst & Young. Zoti Mueller-Marqués Berger ka qenë anëtar i BSNKSP-së, dhe është Kryetar i Grupit Këshillimor Konsultativ prej vitit 2016. Është kryetar i Grupit të Sektorit Publik të organizatës “Accountancy Europe”, dhe prej vitit 2013 e përfaqëson në Projektin e SEKSP-ve të Komisionit Evropian. Ka shërbyer si anëtar i Task Forcës “Metodika e Auditimit” të Gjykatës Evropiane të Audituesve. Po kështu, është anëtar i Këshillit Këshillimor për Kontabilitetin të Komisionit Evropian. Thomas është anëtar i Komitetit të Sektorit Publik pranë Institutit të Audituesve Publikë të Gjermanisë. Në vitin 2016, ka marrë çmimin e Anëtarit të Nderit nga Instituti i Autorizuar i Financave & Kontabilitetit Publik (CIPFA) i Britanisë së Madhe.



### **LIVIA STRAKOVA**

Ekipi për SEKSP-të, Komisioni Evropian, EUROSTAT

---

Livia Shinn Strakova punon për Standardet Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SEKSP), në Komisionin Evropian - Eurostat. Puna e saj fokusohet në nxitjen e rëndësisë së kontabilitetit të harmonizuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara, duke punuar ndërkohë nga afër me ekspertë të Shteteve Anëtare të BE-së për hartimin e parimeve, strukturave dhe proceseve për SEKSP-të, si edhe zhvillimin e studimeve të ndikimit. Më parë ka punuar kryesisht në kontabilitet dhe menaxhim financiar në sektorin privat në Britaninë e Madhe dhe në administratën tatimore sllovaqe. Formimin akademik e ka në ekonomi, financë dhe administrim dhe mban diplomë të nivelit Master.



### **ANTON DUBOVIK**

Zëvendësdrejtor, Thesari Federal, Federata Ruse

---

Anton Dubovik është Zëvendësdrejtor i Thesarit në Rusi. Në fushat e tij të përgjegjësisë janë: kontabiliteti financiar, përpilimi i pasqyrave financiare të konsoliduara, statistikave financiare publike. Anton ka akumuluar përvojë të gjerë praktike në sferën informatike (zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve informatike) si edhe në sferën e MFP-së (kontabiliteti, kontabiliteti i pagave, raportimi financiar dhe administrimi). Anton Dubovik ka marrë pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të Rusisë si ekspert afatshkurtër i FMN-së për statistikave financiare publike.



### **HANA ZORIĆ**

Drejtoreshë Drejtorie, Thesari, Ministria e Financave, Kroaci

---

Hana Zoricic punon në Ministrinë e Financave të Republikës së Kroacisë prej thujse 10 vjetësh. Ministria e Financave ka qenë vendi i parë i punës pas diplomimit nga Fakulteti Ekonomik i Zagrebit. Ka vazhduar arsimimin pa shkëputje nga puna në Ministri dhe ka përfunduar programin ndërkombëtar MBA. Ka punuar në drejtori të ndryshme të Ministrisë së Financave dhe ka zbatuar projekte të ndryshme, përfshirë: zhvillimin e buxhetimit programor dhe buxhetimit me bazë performancën, zhvillimin e sistemit të



planifikimit strategjik në nivel kombëtar së bashku me treguesit kyç të performancës për përdoruesit buxhetorë në nivel qendror dhe vendor, dhe më kompleksi: zhvillimin e metodikës për kryerjen e procesit të shqyrtimit të shpenzimeve së bashku me zbatimin në praktikë. Aktualisht, Hana Zoricic është Drejtoreshë Drejtorie për Kontabilitetin Shtetëror dhe Kontabilitetin e Organizatave Jofitimprurëse, ku trajton zhvillimin e sistemit të kontabilitetit shtetëror dhe raportimin financiar në përgjigje të kërkesës së Eurostatit dhe institucioneve të tjera të BE-së.



### **LIUDMYLA HAPONENKO**

Drejtoreshë Drejtorie, Ministria e Financave, Ukrainë

Liudmyla Haponenko punon pranë Ministrisë së Financave të Ukrainës prej vitit 2015, ku drejton Drejtorinë e Metodikës së Kontabilitetit dhe të Mbështetjes Rregullore të Auditimit. Përpara Ministrisë së Financave, zonja Haponenko i ka kushtuar më se 22 vjet praktikës së kontabilitetit. Drejtorja e drejtuar nga zonja Haponenko siguron metodikën e kontabilitetit dhe mbështetje rregullore për auditimin dhe reformimin e sistemeve të kontabilitetit dhe të auditimit në Ukrainë. Ekipi që drejton zonja Haponenko ka realizuar propozime për përmirësimin e sistemit të kontabilitetit në sektorin publik në Ukrainë, çka është reflektuar në strategjinë e re për modernizimin e sistemit të kontabilitetit dhe të raportimit financiar në sektorin publik për periudhën deri në vitin 2025, si edhe ka ngritur sistemin e mbikëqyrjes publike të aktiviteteve të auditimit në përputhje me kërkesat e legjislacionit evropian dhe me praktikën më të mirë ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, zonja Haponenko mban postet e nënkryetarit të Këshillit Metodik të Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave të Ukrainës, nënkryetarit të Këshillit për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar pranë Ministrisë së Financave të Ukrainës dhe të kryetarit të Këshillit të Mbikëqyrjes së Auditimit pranë Organit të Mbikëqyrjes së Auditimit. Gjithashtu, ajo punon me efektivitet si eksperte e grupeve të punës pranë Programit për Fuqizimin e Auditimit dhe Raportimit në Vendet e Partneritetit Lindor (STAREP), Grupit Këshillimor për Taksonominë e SNRF-ve (GKT), Programit për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik (PULSAR), në Komunitetin e Praktikës për Kuadrin e Raportimit Financiar (KP-KRF).



### **SRINIVAS GURAZADA**

Drejtues Global, Drejtues i ekipit të projektit KP-E, PULSAR, Banka Botërore

---

Srinivas Gurazada është drejtues global për menaxhimin e financave publike (MFP) pranë Bankës Botërore, në Uashington D.K. Detyra e tij është sintetizimi i dijeve globale për MFP-në për t'i ndihmuar qeveritë të zbatojnë me efektivitet politikat buxhetore. Njohuritë dhe interesat e tij përfshijnë fuqizimin e sistemeve shëndetësore, reformat e buxhetit (për shembull, përgatitja e buxhetit në bazë të performancës/në bazë të produktit), mobilizimin e të ardhurave, reformat e kontabilitetit dhe të raportimit financiar, sistemet e kontrollit të brendshëm, auditimin dhe zhvillimin e diagnostikimeve (PEFA, TADAT, PIMA, SAI – PMF, ROSC, PERs etj.). Ka mbi 25 vjet përvojë në menaxhimin e financave publike dhe në qeverisje, pasi ka punuar në qeveritë e Indisë dhe të Omanit, në disa organizata të OKB-së dhe në Bankën Botërore. Është organizues i mbledhjeve të Grupit Teknik të Punës për Menaxhimin Financiar në sektorin shëndetësor dhe është anëtar kryesor i UHC-së 2030. Drejton Komunitetin e Praktikës të Bankës Botërore për Llogaridhënien dhe Institucionet e Mbikëqyrjes, me fokus të veçantë te institucionet e kontrollit të lartë të shtetit. Është drejtues i ekipit të projektit për Komunitetin e Praktikës për Edukimin (KP-E) pranë programit të Kontabilitetit dhe Raportimit në Sektorin Publik (PULSAR).



### **ARMAN VATYAN**

Krye-Specialist për Menaxhimin Financiar – Pikë Qendrore Kontakti për Qeverisjen për Azinë Qendrore, Banka Botërore Drejtues Ekipi KP-KRF në PULSAR

---

Arman Vatyan, kontabilist i autorizuar në Britaninë e Madhe dhe Kanada, Drejtues Programi PULSAR është pikë qendrore kontakti për Praktikën Globale të Qeverisjes në Bankën Botërore, i cili mbikëqyr zbatimin e veprimtarive të BB-së në fushën e Qeverisjes në Azinë Qendrore përfshirë në fushën e menaxhimit financiar. Ai ka më se 20 vjet përvojë në drejtimin e nismave dhe reformave të rëndësishme të menaxhimit financiar, përfshirë në kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik dhe atë privat, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm publik, sistemin e informacionit të menaxhimit financiar (FMIS) dhe kontrollin e brendshëm publik në 24 vende në Evropë dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine dhe Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Ai drejton edhe Komunitetin e Praktikës për Auditimin e Brendshëm të PEMPAL në 23 vende (prej vitit 2008) dhe programe të tjera të suksesshme të MFP. Përpara se t'i bashkohej Bankës Botërore, ka

punuar në KPMG për t'u ofruar këshilla për drejtimin e brendshëm, planifikimin strategjik, MIS, ristrukturimin, marrjet në pronësi dhe privatizimin qeverive dhe njësive ekonomike të mëdha me interes publik. Ka rreth 20 vjet përvojë në mësimdhënie në kurset e ACCA dhe si lektor i jashtëm në universitete dhe programe master.



#### **PATRICK PIKER UMAH TETE**

Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore; Drejtues Ekipi për KPE-në

Patrick Piker Umah Tete punon prej 14 vjetësh në Bankën Botërore dhe aktualisht jep mbështetje këshillimore të kontrollit të cilësisë për menaxhimin financiar për operacionet e financuara nga Banka në Ukrainë, Turqi, Taxhikistan dhe Republikën Kirgize. Ka përvojë në raportimin financiar të shoqërive tregtare, menaxhimin e financave publike dhe menaxhimin financiar për operacionet e Bankës. Patrick ka mbështetur zbatimin me sukses të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik me të drejta dhe detyrime të konstatuara në Tanzani dhe në Komisionin e Bashkimit Afrikan. Ka drejtuar punën për vlerësimin e rezultateve të Projektit të Llogaridhënies në sektorin privat dhe sektorin publik të Azerbajxhanit (CAPSAP) ku janë vënë në zbatim reforma dhe është rritur kapaciteti profesional në kontabilitetin e sektorit publik. Ka përvojë të gjerë në mbështetjen e punës mes vendeve në drejtim të harmonizimit të standardeve të kontabilitetit dhe miratimit për përdorim të SNKSP-ve. Gjithashtu, ka mbështetur organizatat profesionale të kontabilitetit të cilat dëshirojnë ta harmonizojnë edukimin kontabël duke përdorur standardet ndërkombëtare të edukimit të IFAC.

Patrick është anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Autorizuar dhe të Miratuar dhe ka diplomë master në administrim biznesi nga Universiteti i Warwick, Britani e Madhe. Ka marrë formim për menaxhimin financiar publik në Universitetin Harvard, Universitetin e Londrës dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN). Përpara se t'i bashkohej Bankës Botërore, Patrick ka qenë menaxher auditimi pranë KPMG-së.

## PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA


BASHKËFINANCOHET NGA



 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Finance

**CFRR**   
**Centre for Financial  
Reporting Reform**



 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,  
Education and Research EAER  
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**